




Breaking News:

Dibër/Procedohen penalisht 2 shtetas

⏏ ⏪ ⏩



Lajmet

Operacionet

11/10/2025

## Krujë/Njoftim

Krujë

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Krujë, në bashkëpunim me Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore (Rajoni Durrës – Kavajë), nën drejtimin e Prokurorisë, në kuadër të operacionit policor të koduar “Bashkëpunimi”, arrestuan në flagrancë shtetasin E. L., 28 vjeç, me detyrë trupë shërbimi/patrullë e përgjithshme në Komisariatin e Policisë Fushë-Krujë, si dhe shpallën në kërkim vëllain e tij, shtetasin Ç. L., 36 vjeç.

Këta shtetas dyshohen se janë autorë të kultivimit të 65 bimëve narkotike, të dyshuara të llojit Cannabis Sativa, në dy parcela të ndodhura në një zonë pyjore të njësisë administrative Cudhi, Krujë.

Gjatë kontrollit fizik dhe atij të ushtruar në banesën e 28-vjeçarit, u gjetën dhe u sekuestruan dy armë zjarri, njëra prej të cilave pa leje, si dhe një sasi municioni luftarak.

Vijon puna për kapjen e 36-vjeçarit dhe për dokumentimin e plotë të rastit.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

◀ Reagim i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

Fier/Zbulohet një bazë kriminale në lagjen “Kastriot”, ku mbahej arsenal armësh ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON

Google Play



Download on the

App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)